



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1145_05_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 23.06.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 gusht 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Gj. L., me shifër të konsumatorit: DPR - 31269) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1145_05_14 i datës 22.05.2014.

Arsyetim

Me datë 04.03.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 2334395 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 40862554, ku të njëjtin e kanë dërguar në qendrën e kalibrimit për shqyrtim dhe verifikim.

Me datë 21.04.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 2334395, ku është konstatuar se njehsori elektrik pllombat shtetërore i ka te manipuluar të hapura dhe prapë te mbyllura nga pjesa e jashtme qelqi i krisur, numëruesi i njehsorit është manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa te numrave në numëror. Pas procesit të kalibrimit punëtorët e autorizuar te KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 07.06.2008 kanë dalur te konsumatori dhe kanë evidentuar profilin e kabllit të furnizimit.

Pas kësaj Departamenti i Faturimit në KEK me datë 16.06.2008 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06011 në vlerë financiare prej 841.80€. Pas kësaj ngarkese konsumatori ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Departamenti për konsumator në KEK pas shqyrtimit të ankesës e ka refuzuar ankesën e konsumatorit.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-u ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të konsumatorit. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 22.05.2014 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga



KEDS-i, të shkarkojë konsumatorin me shifër me shifër DPR – 31269 nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06011 të datës 16.06.2008 në vlerë financiare prej 841.80€.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesën është se vendimi i DMK në ZRRE është vendim i gabuar dhe jo i plotë sa i përket gjendjes faktike, për faktin se sektori i kalibrimit ka konstatuar se njehsori elektrik pllombat shtetërore i ka te manipuluar të hapura dhe prapë te mbyllura nga pjesa e jashtme qelqi i krisur, numëruesi i njehsorit është manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa te numrave në numëror. Në ankesë është theksuar se DMK ka bërë shkelje të nenit 4, pika 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ku si provë ka bashkangjitur Aktjykimin penal P.nr. 1499/08 i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 03.09.2010. Në ankesë po ashtu është theksuar se sa i përket krahasimit të shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit nuk është parametër i saktë i vlerësimit pasi që një konsumatorët para ndërrimit e shfrytëzojnë energjinë me të gjitha aparaturat që disponojnë, ndërsa pas ndërrimit rezervohen të shpenzojnë pasi energjia elektrike i regjistrohesh në njehsor.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KEDS nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje dhe se cilën dispozitë ligjore e ka shkelur.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë shpenzimi të energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik ka vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 2334395 prej periudhës 08/2002 e deri më 03/2008 është 906.38 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike njehsorit elektrik të ri nr. 40862554 prej periudhës 04/2008 e deri në periudhën 12/2013 është 853.94 kWh/muaj, dhe se sipas kësaj vërehet qartë se me njehsorin e ri elektrike kemi rënie të shpenzimit prej 6.14% në krahasim me njehsorin vjetër. Konstatimet e KEDS-it në pikën se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike nuk është parametër i saktë, Bordi i ZRRE-së thekson se ky konstatim i KEDS-it nuk është i saktë pasi që jo vetëm në vitin e parë pas ndërrimit të njehsorit, por edhe në vitet tjera pas ndërrimit të njehsorit elektrik shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin e ri ka qenë më i ulët se me njehsorin e vjetër, dhe se ky është një fakt konkret që tregon se shpenzimi i energjisë elektrike nuk ka ndryshuar shumë madje ka pasur edhe rënie. Në dokumentet e lëndës së konsumatorit Bordi i ZRRE ka vërejtur se njehsori elektrik nr. 2334395 është prodhim i vitit 1975 dhe se nuk ka asnjë të dhënë se i është bërë më parë kontrollimi (kalibrimi) atij njehsori.

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë faturës së rikthimit të humbjeve ka vërejtur se KEK në momentin e ngarkimit të konsumatorit me faturën e rikthimit të humbjeve nuk ka respektuar rregullat për llogaritjen e kësaj fature, pasi që në momentin e kalkulimit ka përdorur dy vlera të ndryshme në një të njëjtë vlerë prej 6.90 € dhe vlerën tjetër prej 20.00€, e që në rastin konkret KEK ka qenë e obliguar të llogarisë vetëm me vlerën e parë, ndonëse kjo pjesë e gabimit është pranuar edhe nga vet KEDS-i tani duke theksuar se ka ndodhur gabim teknik gjatë llogaritjeve dhe se kjo faturë do të rregullohet.

Mbështetur në nenin 8 paragrafi 8.3 të Rregullës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike theksohet: *“Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur”*.

Bordi gjatë analizës së bërë faturës së shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) nr DPR08HP06011 të datës 16.06.2008 ka vërejtur se KEK në momentin e ngarkimit të konsumatorit me faturën e rikthimit të humbjeve nuk ka respektuar rregullat për llogaritjen e kësaj fature, pasi që në



momentin e kalkulimit ka përdorur dy vlera të ndryshme në njëren vlerë prej 36.95 €, dhe vlerën tjetër prej 61.00€, e që në rastin konkret KEK ka qenë e obliguar të llogarisë vetëm me vlerën e parë.

Një fakt tjetër që Bordi i ZRRE-së e ka analizuar është se, në procesverbalin e kalibrimit është konstatuar se njehsori elektrik pllombat shtetërore i ka të manipuluar, të hapura dhe prapë të mbyllura nga pjesa e jashtme qelqi i krisur, numëruesi i njehsorit është manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numëror, ndërsa në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik nuk është evidentuar se qelqi i njehsorit elektrik që është i krisur, gjë që është dashur të evidentojnë atë defekt, pasi që ai defekt është i dukshëm dhe do të duhej të evidentohej një defekt i tillë në procesverbal.

Sa i përket pikës së KEDS-it në të cilën theksohet se konsumatori ka një aktgjykim penal P.nr. 1499/08 i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 03.09.2010, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë shqyrtimit dhe analizimit të hollësishëm të lëndës së konsumatorit nuk ka gjetur elemente me të cilin vërtetohet se konsumatori i ka shkaktuar dëm KEK-ut sa i përket shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, sipas konstatimeve të cekura më lartë.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1145_05_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar